# SYLLABUS I LËNDËS “DREJTSHKRIMI I GJUHËS SHQIPE”

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Filologjisë |
| **Titulli i lëndës:** | **Drejtshkrimi i gjuhës shqipe** |
| **Programi:** | Gjuhë shqipe dhe letërsi |
| **Niveli:** | Baçelor |
| **Statusi lëndës:** | Zgjedhore |
| **Viti i studimeve:** | Viti III, Semestri VI |
| **Numri i orëve në javë:** | 2 + 1 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 3 |
| **Koha / lokacioni:** | Universiteti ‘’Ukshin Hoti’’ Prizren |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili** |
| **Të dhënat kontaktuese:** | manjola.brahaj@uni-prizren.com |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Synimi kryesor i kursit “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” ka të bëjë me përvetësimin e njohurive gjuhësore mbi normën e drejtshkrimit, drejtshqiptimit dhe leksikut të gjuhës shqipe si dhe lidhjen e njohurive me zbatimin praktik. Zbatimin praktik të tyre të fokusuar në shkrimin akademik dhe të komunikimit të përditshëm. Kursi synon t’i përgatitë studentët për të shkruar dhe folur saktë gjuhësisht në situate të ndryshme komunikimi duke patur parasysh gjuhën standarde, drejtshkrimin, por edhe varietete të ndryshme stilistikore. Pjesë e përmbajtjes së kursit do të jetë edhe qasja mekanike ndaj tekstit, duke i aftësuar studentët të respektojnë edhe kriteret formale të teksteve të ndryshme gjuhësore dhe shkencore. Një fokus tjetër do te jetë edhe kuptimi dhe analizimi i teksteve të nivelit të lartë, siç është teksti letrar. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Qëllimi i lëndës është që t’i aftësojë të shkruajnë e të flasin gjuhën standard shqipe, duke u bazuar në rregullat dhe parimet bazë të “Drejtshkrimit të shqipes”.<br>Gjithashtu programi i këaj lënde ka si qëllim që me anë të njohurive, rrregullave dhe shembujve të shumë që do t’u parashtrojë studentëve t’i aftësojë ata që të jenë në gjendje të që me kompetencë të hetojnë e tëpërmirësojnë gabimet gjuhësore në punimet, shkrimet, kërkimet dhe projektet e tyre në të ardhmen. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit**: | Gjatë dhe pas përfundimit të kësaj lënde studentë;<br>• Njohin normën leksikore,për pasurinë dhe nevojën e përdorimit të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja.<br>• Përshkruajnë llojet e parimeve dhe rregullave mbi bazën e të cilave funksionon drejtshkrimi i gjuhës shqipe;<br>• përvetësojnë shkrimin dhe shqiptimin e drejtë të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, përdorimin e shkronjave të mëdha, rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit; |

| | |
|---|---|
| | • shpjegojnë në fjali dhe kkomunikime të ndryshme arsyet e përdorimit të shenjave të ndryshme të pikësimit;<br>• zbatojnë normën morfologjike të shqipes standarde: përdorimine drejtë (sipas rregullave të drejtshkrimit) të emrave, foljeve, mbiemrave, përemrave, ndajfoljeve, parafjalëve, pjesëzave, lidhëzave, dhe përdorimin e drejtë të nyjës etj. |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 Javë | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 javë | 15 |
| Punë praktike | 1 | 4 Javë | 4 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 1 | 1 |
| Ushtrime në terren | - | - | - |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 5 javë | 15 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 4 javë | 4 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 1 javë | 2 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 2 javë | 2 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 1 | 2 javë | 2 |
| Projektet, prezantimet ,etj | - | - | - |
| **Totali** | | | **75 orë (3 ECTS)** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentin pjesëmarrës aktiv, jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjëratë.<br>ECTS-sistemi europian i transferimit dhe procesi i akumulimit të kredive, është një sistem i orientuar kah studenti dhe paraqet vleftën e ngarkesës së tij për të arritur objektivat e një lënde (kursi) ose programi të caktuar të studimit.<br>Ngarkesa e studentit sipas ECTS bazohet në kohën që nevojitet për t'i kompletuar aktivitetet e planifikuara rreth një lënde (kursi), siç janë: pjesëmarrja në ligjërata, aktiviteti dhe pjesëmarrja në ushtrime, puna në terren, përgatitja e projekteve dhe plankonspekteve, prezantimet dhe mbajtjet e orëve, punime seminarike, punë konsultative me mentorin, puna e pavarur në bibliotekë ose në shtëpi, përgatitja përfundimtare e provimit, koha e kaluar në provim dhe parametra të tjerë. |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolekviumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.<br><br>1. Testi i parë: 1 – 40% |

| | |
|---|---|
| | 2. Testi i dytë: 1 – 40 %<br>3. Prezantimet studentore – 10 %,<br>4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10%<br>5. Totali: 100 %<br><br>(Vlerësimi në pikë:<br>01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10) |
| **Literatura** | |
| **Literatura primare:** | ***Drejtshkrimi i gjuhës shqipe***, Tiranë, 1973; Prishtinë, 1974.<br><br>ASHSH, ***Fjalor i gjuhës shqipe***, Tiranë, 1980; 2006.<br><br>A. Dhrimo, R. Memushaj, ***Fjalor drejtshkrimor***, Toena, Tiranë, 2011.<br><br>ASHSH, ***Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe***, Tiranë, 1974. |
| **Literatura shtesë:** | R. Memushaj, ***Shqipja standarde***, Toena, Tiranë, 2011.<br><br>Xh. Beqiraj, ***Studime për shqipen I***, UPZ, Prizren, 2021. |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | ***Objekti i lëndës së Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*** | Ushtrime me shkrim për të parë se sa e zotërojnë studentët drejtshkrimin. |
| *Java e dytë:* | ***Parime të përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe*** | Ushtrime lidhur me parimet epërgjithshme të drejtshkrimit përmes analizës së fjalëve. |
| *Java e tretë:* | ***Drejtshkrimi i i zanoreve*** | Ushtrime lidhur me drejtshkrimin e zanoreve. |
| *Java e katërt:* | ***Grupet e zanoreve dhe të diftongjeve*** | Ushtrime lidhur me drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e grupeve të zanoreve dhe diftongjeve. |
| *Java e pestë:* | ***Takime zanoresh ,apostrofi*** | Ushtrime lidhur me takimin e dy tingujve të njëjtë në fjalë; apostrofi. |
| *Java e gjashtë*: | ***Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve.*** | Ushtrime për bashkëtingëlloret. |
| *Java e shtatë:* | ***Disa tipa fjalësh me prejardhje të huaj dhe emra të përveçëm të huaj*** | Ushtrime për disa tipa fjalësh me prejardhje të huaj. |
| *Java e tetë:* | ***Testi i parë vlerësues*** | Ushtrime për test. |
| *Java e nëntë:* | ***Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes*** | Ushtrime. Kur fjalët shkruhen të ndara dhe me vizë në mes. |
| *Java e dhjetë:* | ***Përdorimi i shkronjave të mëdha*** | Ushtrime për përdorimin e shkronjës së madhe. |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | ***Shkrimi i nyjës së përparme; shkrimi i nyjave, i pjesëzave dhe i*** | Drejtshkrimi i nyjave, pjesëzave dheparafjalëve të përsëritur. |

| | | |
|---|---|---|
| | ***parafjalëve të përsëritura*** | |
| *Java e dymbëdhjetë:* | ***Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit; shkrimi i datave*** | Ushtrime praktike për shkrimin e fjalëve në fund të rreshtit dhe të datave |
| *Java e trembëdhjetë:* | ***Pikësimi: shenjat e pikësimit, klasifikimi*** | Ushtrime për pikësimin |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | ***Shenjat e pikësimit në fund të fjalisë*** | Shembuj dhe ushtrime për shenjat e pikësimit në fund të fjalisë. |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | ***Testi i dytë vlerësues*** | Ushtrime për test. |
| **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes** | | |
| Studentët duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve e vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe Këshilli Mësimor.<br>Pritet që secili student të vijë me kohë.<br>Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e nevojshme (e domosdoshme).<br>Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës përfundimtare. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave. | | |